



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dostigjen / Received / Delivered	22. 12. 2021	vit / god / year
Organ / Organiza / Org / Organi	6296 / 2021	Kopje / Kopije / Copies
Mr Post / Dr Post / Post No		Kopje / Kopije / Copies
SKIPINGHEK		1 / 8



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.887/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përshëryje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Flakron Gashi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.887/2021 të datës 25.10.2021 të parashtruar nga ankuesi i përfaqësuar me autorizim nga Avokati me adresë: Rruga "Fehmi Agani", Hyrja 154, kati I, nr.8, Komuna e Prishtinës, kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillin dhe votim të mbajtur më datën 22.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET si e bazuar** ankesa me numër A.nr.887/2021 e datës 25.10.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. **SHFUQIZOHET** Vendimi numër prot:1412/02 i Udhëheqëses së Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit/DMZP i datës 25.10.2021
- III. **SHFUQIZOHET** Vendimi për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve i datës 15.10.2021 më numër:5/2021 i Komisionit Shtetëror të Pranimit dhe **anulohet** procedura rekrutimit për pozitën "Drejtor Ekzekutiv në ARC/MPB" të shpallur në konkursin e datës 11.06.2021 me numër Reference:RN00007102.
- IV. **OBLIGOHET** Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit ligjor prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas shkresave të lëndës i punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme në pozitën Drejtor i Drejtorit të Gjendjes Civile ARC, ndërsa me vendimin e datës 24.07.2021 i njëjti është caktuar në pozitën Zëvendësues i Drejtorit Ekzekutiv në Agjencinë e Regjistrimit Civil, ndërsa ankuesi sipas shkresave të lëndës, ka aplikuar në konkursin e datës 11.06.2021 me numër reference:RN00007102 për pozitën Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Regjistrimit Civil/MPB të shpallur nga MPB.

Ankuesi, është ftuar për pjesëmarrje në testin me shkrim dhe intervistën me gojë, ndërsa me datë 19.10.2021 është njoftuar se Udhëheqësja e Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit/DMZP-MPB ka nxjerr Vendim me të njëjtën datë me numër:1375/02 me arsyetimin se ankuesi pas vlerësimit profesional nga Komisioni Shtetëror i Pranimit nuk ka arritur pragun minimal të 70% të pikëve të përgjithshme të nevojshme për të vazhduar procedurat e mëtejshme të emërimit gjegjësisht sipas këtij vendimi ankuesi nuk ka arritur pikë të mjaftueshme që të listohet në mesin e tre kandidatëve më të mirë për dërgimin e listës për emërim në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Ankuesi kundër Vendimit të datës 19.10.2021 me numër:1375/02 të Udhëheqëses së Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit/DMZP-MPB ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është pranuar më datë 25.10.2021 dhe është protokolluar me numër: 5166/2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datën 05.11.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Me datë 17.11.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministrinë e Punëve të Brendshme me shkresat e bashkëngjitura të lëndës. Këshilli sërish me datë 01.12.2021 ka kërkuar prova shtesë ndërlidhur me ankesën e ankuesit, ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme me datë 09.12.2021 ka ofruar provat e kërkuara shtesë.

Kryetari i Kolegjit më datë: 01.12.2021, ka bërë Kërkesë tek Kryesuesi i KPM SHCK që lëndës së ankuesit konform nenit 17 paragrafit 2 të ligjit Nr.06/L048 për KPM SHCK ti vazhdohet afati edhe për 10 ditë pune për vendimmarrje për shkak të rrethanave specifike të funksionimit të Këshillit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritore administroj këto prova:
Ankesën me numër protokollit 5166/2021 e datës 25.10.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 20.10.2021; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Vendimin e datës 19.10.2021 me numër:1375/02 të Udhëheqëses së Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit/DMZP-MPB; E-mailin e datës 19.10.2021 dërguar nga ankuesi për me korrespondencën e bashkëngjitur prej dy (2) faqesh; Shkresa e Ambasadës Britanike me rezultatin e përgjithshëm të pikëve për ankuesin; Njoftimin e datës 18.10.2021; E-mailin e datës 25.10.2021 dërguar nga ankuesin; Vërtetimin mbi përvojën e punës së ankuesit i datës 26.07.2021; Diplomën e ankuesit me numër:24/2015 të datës 22.10.2015; Diplomën e ankuesit të datës 10.04.2002 me numër:187; Çertifikatën e lëshuar nga United States Department of Justice e datës 26.04.2012; Çertifikatën e lëshuar nga CRPK dhe UNHCR; Çertifikatën e lëshuar nga United States Department of Justice e datës 17.05.2019; Diplomën e datës 08.02.2001 lëshuar Akademia Diplomatike Shqiptare; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin i datës 06.01.2020; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin i datës 15.01.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 05.11.2021; E-mailin e datës 09.11.2021 dërguar nga ankuesin në Këshill; Përgjigjen në kërkesë të datës 17.11.2021; Konkursin e datës 11.06.2021 me numër reference:RN000712 për pozitën Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Regjistrimit Civil/MPB; Vendimin e datës 20.08.2021 për vazhdimin e afatit të procedurave të rekrutimit; Lista e kandidatëve që kanë aplikuar; Njoftimin për listën e shkurt të kandidatëve e datës 09.08.2021; E-mailin e datës 10.08.2021 dërguar nga A.K për ankuesin;

E-mailin e datës 25.10.2021 dërguar nga Sh.H për ankuesin; E-mailin e datës 19.10.2021; Vendimin e datës 25.10.2021 të Udhëheqëses e Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit/DMZP-MPB me numër prot:1412/02; Vendimin për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve i datës 15.10.2021 më numër:5/2021; E-mailin e datës 29.10.2021 dërguar nga Sh.L për Sh.H; Listën e poentimit nga intervista e nënshkruar nga të gjithë anëtarët; Renditjen përfundimtare të kandidatëve e datës 15.10.2021; E-mailin e datës 27.09.2021 dërguar nga A.K për ankuesin; E-mailin e datës 27.10.2021 dërguar nga Sh.L për A.K; testin me shkrim të ankuesit; Aplikacionin me dokumentet e bashkangjitura të ankuesit; Diplomën e datës 22.10.2015 me numër Nr.24/2015; Diplomën e datës 10.04.2002 me numër:187; Vërtetimin mbi përvojë e marrëdhënies së punës i datës 26.07.2021; Vendimin e datës 08.02.2012; vendimin për emërim i datës 30.11.2009; Akt emërimin e ankuesit të datës 06.02.2015; vendimin e datës 24.05.2021 me numër:0194/2021; Rekomandimin për përtëritjen e kontratës i datës 22.03.2005; Kontratën e datës 13.04.2004; Kontratën e datës 12.04.2007; Kontratën e datës 01.01.2008; Kontratën e datës 13.04.2005; Formularin e Vlerësimit të rezultateve në punë i datës 06.01.2020; Formularin e Vlerësimit të rezultateve në punë i datës 15.01.2021; Aplikacionin e kandidatës ne dokumentet e bashkangjitura; Formularin e Vlerësimit të rezultateve në punë i datës 06.01.2020; Formularin e Vlerësimit të rezultateve në punë i datës 15.01.2020; Kontratën e punës të datës 15.12.2004; Kontratën e punës të datës 16.03.2001; vendimin e datës 06.04.2009; Vendimin e datës 05.02.2015; Akt emërimin e datës 31.01.2013; Diplomën e datës 08.02.2001 lëshuar nga Akademia Shqiptare Diplomatike; Diplomën e datës 08.12.2003 me numër:597; Çertifikatën e datës 28.10.2019; Çertifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë të datës 13.07.2021; Çertifikatën e lëshuar nga United States Department of Justice e datës 17.05.2019 për kandidaten Çertifikatën e datës 26.04.2012; Çertifikatën e lëshuar nga United States Department of Justice e datës 26.04.2012 për kandidaten Çertifikatën e datës 07.03.2008; Çertifikatën e datës 10.03.2008; Çertifikatën e lëshuar nga GTZ; Çertifikatën e datës 31.05.2012; Çertifikatën e datës 30.11.2006; Çertifikatën e lëshuar nga Naional Albanian American Council për kandidaten Çertifikatën e lëshuar nga GTZ me datë 02.07.2004; Aplikacionin e kandidatit ne dokumentet e bashkangjitura; Vërtetimin e datës 26.07.2021 lëshuar nga AAB; Vërtetimin e datës 14.07.2021 mbi marrëdhënien e punës në MPB; Çertifikatën e datës 17.06.2021; Çertifikatën e datës 21.11.2006; Çertifikatën e datës 31.05.2021; Çertifikatën e lëshuar nga CRC Sogema; Shkresën për certifikim nga Microsoft lëshuar nga B.Gates; Çertifikatën e lëshuar me datë 27.03.2008; Vërtetimin e lëshuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore/MPB lidhur me përvojën e punës i datës 14.07.2021; Vërtetimin e datës 19.08.2013; Vërtetimin e datës 06.08.2013; Diplomën e datës 07.07.2009 me numër:223/09; Diplomën e datës 17.05.2013 me numër:202/13; Formularin e Vlerësimit të rezultateve në punë i datës 14.02.2020; Formularin e Vlerësimit të rezultateve në punë i datës 01.02.2021; Shkresën e datës 23.07.2021 lëshuar nga SEE University; Mirënjohjen e datës 13.02.2006; Mirënjohjen e lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit; Çertifikatën e lëshuar nga Ambasada Amerikane në Prishtinë muajt shtator 2019; Çertifikatat e lëshuar nga Microsoft të datës 14.01.2005 me numër ref:2071 dhe 2072; Çertifikatën e lëshuar nga Microsoft e datës 18.03.2005; Çertifikatën e lëshuar nga Microsoft e datës 19.04.2005; Çertifikatën e lëshuar nga Microsoft e datës 09.05.2005; Çertifikatën e lëshuar nga Microsoft e datës 03.06.2005; Çertifikatën e lëshuar nga Microsoft e datës 27.06.2005; Çertifikatën e lëshuar nga Microsoft e datës 22.07.2005; Çertifikatën e lëshuar nga Microsoft e datës 19.08.2005; Çertifikatën e lëshuar nga Microsoft e datës 08.05.2009; Çertifikatën e datës 28.06.2019; Formularin e Prezantimit dhe Intervistës (21.09) për ankuesin i vlerësuar nga S.F i datës 14.10.2021 me Regjistrin e pikëve nga intervista; Formularin e Prezantimit dhe Intervistës (21.09) për ankuesin i vlerësuar nga R.K i datës 15.10.2021 me Regjistrin e pikëve nga intervista; Formularin e Prezantimit dhe Intervistës (21.09) për ankuesin i vlerësuar nga B.Xh i datës 15.10.2021 me Regjistrin e pikëve nga intervista; Formularin e Prezantimit dhe Intervistës (21.09) për ankuesin i vlerësuar nga A.B i datës 15.10.2021 me Regjistrin e pikëve nga intervista; Formularin e Prezantimit dhe Intervistës (21.09) për ankuesin i vlerësuar nga E.G i datës 15.10.2021 me Regjistrin e pikëve nga intervista; Regjistrin e Vlerësimit të CV-së së ankuesit nga anëtari A.B i datës 12.10.2021, Regjistrin e Vlerësimit të CV-së së ankuesit nga anëtari B.XH i datës 12.10.2021, Regjistrin

e Vlerësimit të CV-së së ankuesit nga anëtari S.F i datës 12.10.2021, Regjistrin e Vlerësimit të CV-së së ankuesit nga anëtari E.D i datës 12.10.2021, E-mailin e datës 08.12.2021 dërguar nga Arkiva e MPB për Këshillin me numër prot:5888/2021 lidhur me proat shesë të kërkuara; E-mailin e datës 07.12.2021 dërguar nga B.Xh për Sh.L; E-mailin e datës 07.12.2021 dërguar nga R.K për Sh.L; E-mailin e datës 02.12.2021 dërguar nga E.G për Sh.L; E-mailin e datës 08.12.2021 dërguar nga E.G për LP; E-mailin e datës 06.12.2021 dërguar nga [] për Sh.L; E-maili i datës 27.10.2021 dërguar nga Sh.L për Ministrin e MPB-së me njoftim e pezullimit të procedurës së rekrutimit referuar ankesës së ankuesit të datës 25.10.2021 në Këshill; E-mailin e datës 08.12.2021 dërguar nga A.G për LP me korrespondencën e bashkangjitur prej tre (3) faqesh; E-mailin e datës 08.12.2021 dërguar nga Sh.L për B.Sh me korrespondencën e bashkangjitur prej dy (2) faqesh; Testi me shkrim i kandidatit [] Testi me shkrim i kandidatës []; Formularin e Prezantimit dhe Intervistës (21.09) për kandidatin [] i vlerësuar nga R.K i datës 13.10.2021 me Regjistrin e pikëve nga intervista; Formularin e Prezantimit dhe Intervistës (21.09) për kandidatin [] i vlerësuar nga S.F i datës 13.10.2021 me Regjistrin e pikëve nga intervista; Formularin e Prezantimit dhe Intervistës (21.09) për kandidatin [] i vlerësuar nga E.G i datës 13.10.2021 me Regjistrin e pikëve nga intervista; Formularin e Prezantimit dhe Intervistës (21.09) për kandidatin [] i vlerësuar nga B.Xh i datës 13.10.2021 me Regjistrin e pikëve nga intervista; Formularin e Prezantimit dhe Intervistës (21.09) për kandidatin [] i vlerësuar nga A.B i datës 13.10.2021 me Regjistrin e pikëve nga intervista; Formularin e Prezantimit dhe Intervistës (21.09) për kandidaten [] i vlerësuar nga S.F i datës 15.10.2021 me Regjistrin e pikëve nga intervista; Formularin e Prezantimit dhe Intervistës (21.09) për kandidaten [] i vlerësuar nga A.B i datës 15.10.2021 me Regjistrin e pikëve nga intervista; Formularin e Prezantimit dhe Intervistës (21.09) për kandidaten [] i vlerësuar nga B.Xh i datës 15.10.2021 me Regjistrin e pikëve nga intervista; Formularin e Prezantimit dhe Intervistës (21.09) për kandidaten [] i vlerësuar nga E.G i datës 15.10.2021 me Regjistrin e pikëve nga intervista; Formularin e Prezantimit dhe Intervistës (21.09) për kandidaten [] i vlerësuar nga R.K i datës 15.10.2021 me Regjistrin e pikëve nga intervista.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit [] është e *bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se procedurat e rekrutimit për pozitën Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë së Regjistrimit Civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme e shpallur sipas konkursit të datës 11.06.2021 me numër reference:RN000712 është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Rregullores nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të lartë Drejtues, si dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi pasi që i njëjti vlerëson së është dëmtuar me rastin e vlerësimit të jetëshkrimit-CV-së dhe po ashtu është dëmtuar gjatë ndërhyrjeve (zbritjes së pikëve) në regjistrin e pikëve nga Komisioni Shtetëror Përzgjedhës me ç ‘rast i është pamundësuar të kalojë pragun minimal prej 70% të totalit të përgjithshëm pikëve i nevojshëm për të qenë pjesë e listës për emërim, listë e cila dërgohet në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se konkursi i datës 11.06.2021 me numër reference:RN00007102 për pozitën Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Regjistrimit Civil/MPB ka paraparë këto kërkesa të përgjithshme formale:

- “Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Në paku test (8) vite përvojë pune profesionale, duke përfshirë së paku pesë (5) vite përvojë pune në pozita drejtuese”.

Kolegji duke u bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se ankuesi edhe kandidatët e tjerë i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara në konkurs, andaj mbi këtë bazë Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me rastin e përfshirjes në listën e ngushtë si dhe dërgimin e njoftimit për t'iu nënshtruar procedurave të tjera të rekrutimit, kanë vendosur në pajtueshmëri me dispozitat e Rregullores nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të lartë Drejtues gjegjësisht nenit 8 paragrafi 2 dhe 3 ku përcaktohet se: *"Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikacionit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak. 3. Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin në fazën e mëtejshme"*

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave gjatë shqyrtimit të vlerësimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, ka konstatuar se Formularin e Prezantimit dhe Intervistës (21.09) për ankuesin i vlerësuar nga A.B i datës 15.10.2021 me Regjistrin e pikëve nga intervista ka pasur ndërhyrje-korrigjim dhe zbritje të pikëve ashtu që me këqyrje të formularit të intervistës konstatohet se tek vlerësimi anëtarit të komisionit A.B, shihet qartë se është bërë zbritje e pikëve me qëllim që ankuesit ti bëhet e pa mundur të kaloj pragun prej 70%, prag ky i njafuëshëm që të vazhdoj procesin e më tejme të rekrutimit. Po ashtu edhe në Formularin e Prezantimit dhe Intervistës (21.09) për ankuesin i vlerësuar nga anëtari i komisionit E.G i datës 15.10.2021 me Regjistrin e pikëve nga intervista ka pasur ndërhyrje-korrigjim dhe zbritje të pikëve me çka shihet qartë se qëllimi i dy anëtarëve të Komisionit ka qenë të dëmtohet ankuesi

Prandaj nisur nga ky fakt është e pa kontestueshme se dy nga anëtarët e Komisionit kanë vepruar në kundërshtim me

Neni 6

Parimet e pranimit të zyrtarëve publikë

"Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativo teknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve..." të Ligjit. 06/L-114 për Zyrtar Publikë.

Me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe vendosjes meritore përkritazi me gjendjen faktike dhe provat e administruara, me datë 01.12.2021 Këshilli i është drejtuar me kërkesë për prova shtesë, citat: *"Deklaratë me shkrim lidhur me ndërhyrjen-korrektimin e pikëve në Regjistrin e Pikëve të Intervistës (për ankuesin) nga A.B Anëtar i Komisionit Shtetëror të Pranimit (në bazë të renditjes së formularit Prezantimi dhe Intervista del që formulari është plotësuar në zyrat në fjalë); Deklaratë me shkrim lidhur me ndërhyrjen-korrektimin i pikëve në Regjistrin e Pikëve të Intervistës (për ankuesin) nga znj. Anëtare e Komisionit Shtetëror të Pranimit (në bazë të renditjes së formularit Prezantimi dhe Intervista del që formulari është plotësuar nga zyrtarja në fjalë), ndërsa në deklaratën me shkrim të dërguar përmes e-mailit të datës 06.12.2021 anëtari i Komisionit Shtetëror Përzgjedhës deklaroi se: "Konform kërkesës suaj sa i përket procedurës Drejtor i Përgjithshëm i ARC-së e konfirmoj se pikët në formularë janë të sakta", ndërsa anëtarja e Komisionit Shtetëror Përzgjedhës E.G në deklaratën me shkrim të dërguar përmes e-mailit të datës 02.12.2021 ka deklaruar se: "... deklaroi se në procedurën e rekrutimit për pozitën Drejtor i përgjithshëm në Agjencinë e Regjistrimit Civil, mbaj përgjegjësi për pikët e vlerësimit të vendosura në formularin tim të vlerësimit për vlerësimin e kandidatit Formulari është dokument pune i mbajtjes së shënimeve, që reflekton plotësisht shënimet e mbajtura në at formularë përkritazi me komponentët e vlerësuar të intervistimit. Formulari*

si i tillë mund të ketë shënime, rishtime dhe komente-është fletore pune. Në fund vlerësimi final vendoset në sistem elektronik dhe ai është vlerësimi përfundimtar zyrtar të cilit duhet t'i referohemi dhe i cili i reflekton pikët". Kolegji në bazë të përgjigjes së dhënë nga dy anëtarët e Komisionit konstaton se nuk mund të vij deri tek e vërteta se cila ka qenë arsye e ndërhyrjeve në korigjimin e pikëve në formularin e intervistës lidhur me ankuesin për më tepër njëra nga anëtarët e Komisionit E.G ka deklaruar se formularët janë "fletore pune", ky konstatim i anëtares A.G është jo i saktë në raport me procedurën e rekrutimit për të cilën bëhet fjalë, sepse kjo është në kundërshtim me

Neni 5

Kërkesat dhe kushtet e Pranimit

"3.Procesi i vlerësimit të kriterëve dhe kërkesave të përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni do të mbështetet nëpërmjet udhëzuesve që do të hartohen nga DMZP...", të Rregullores Nr. 15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues"

Gjithashtu Kolegji me qëllim të krahasimit (edhe pse kjo Rregullore nuk zbatohet për këtë procedurë të rekrutimit) i referohet edhe

Neni 65

Formularët

"Formularët DMZP përgatitë dhe i miraton Formularët përkatës të obligueshëm për zbatimin e procedurave të kësaj rregulloreje. Formularët publikohen në web-faqe të DMZP dhe janë të qasshëm për të gjitha palët e interesuara" të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës".

Prandaj nga kjo që u tha më lartë Kolegji konstaton se Formularët e intervistimit janë dokumente zyrtare dhe jo fletore pune në të cilën mund të shkruhet vetëm vlerësimi objektiv dhe nuk mund të ndërhyhet me qëllim të ndryshimit të pikëve dhe të dëmtohet me qëllim njëri nga kandidatët e në këtë rastë është dëmtuar ankuesi

Po ashtu, Kolegji duke u bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht, Vërtetimit të datës 26.07.2021 të lëshuar nga Menaxherja e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Punëve të Brendshme dëshmohet se ankuesi i ka mbi shtatëmbëdhjetë (17) vite përvojë punë udhëheqëse-drejtuese, prej tyre të paktën pesë (5) vite përvojë pune në pozitë të lartë drejtues e cila llogaritet si pozita më e lartë menaxheriale apo udhëheqëse në Shërbimin Civil sipas dispozitave të Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 33 paragrafi 2 nën paragrafët 2.1; 2.2; 2.3 dhe 2.4 ku përcaktohet se: 2. Pozitat në Shërbimin Civil ndahen në këto kategori: "2.1. *Kategoria e lartë drejtuese, që përfshin këto pozita: sekretar i përgjithshëm, drejtor ekzekutiv dhe zëvendësdrejtor i një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme*; 2.2. *Kategoria e mesme drejtuese, që përfshin këto pozita: drejtor i departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të*; 2.3. *Kategoria e ulët drejtuese, që përfshin këto pozita: shefi i divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të*; dhe 2.4. *Kategoria profesionale, që përfshin zyrtarët profesionalë"*; ndërsa sipas Formularëve të regjistrimit vlerësimit të CV-së, tre prej anëtarëve të Komisionit Shtetëror të Pranimit në "Pikën 2 -Kriteri i Përvojës së Punës", ankuesin nuk e kanë vlerësuar me notën dhjetë (10)-si vlerësimi maksimal, sepse vlerësimi i përvojës së punës sipas Kolegjit duhet të bëhet në mënyrë të saktë sipas dokumenteve të përvojës së punës dhe në bazë të shkresave të lëndës dy nga kandidatët tjerë që i plotësojnë kushtet për këtë procedurë në raport me ankuesin kanë përvojë të ndryshme, sepse ankuesi ka qenë për disa vite në pozitë të lartë drejtuese dhe komisioni ka dështuar që të vlerësoj drejtë përvojën e punës së ankuesit.

Sipas Kolegjit qëndron pretendimi i ankuesit se me rastin e vlerësimit të përvojës së punës nga ana e Komisionit është shkelur

Neni 6

Parimet e pranimit të zyrtarëve publikë

“Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativo teknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve...” të Ligjit. 06/L-114 për Zyrtar Publikë.

Dhe gjithashtu është vepruar në kundërshtim me

Neni 4

Llojet e trajtimit të pabarabartë

1. Llojet e trajtimit të pabarabartë janë si në vijim: 1.1. Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji”, të Ligjit Nr.05/021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, meqenëse ka evidentuar dukshëm shkelje në procedurën e rekrutimit për pozitën e Kryeshfeti Ekzekutiv të Agjencisë së Regjistrimit Civil me faktin se ndaj ankuesit Komisioni Shtetëror i pranimit i ka korigjuar-ndryshuar pikët nga vlerësimi fillestar duke ia pamundësuar të njëjtit të jetë pjesë e listës përzgjedhëse përfundimtare për emërim, konstaton se procedura e rekrutimit për pozitën në ljalë e shpallur sipas konkursit të datës 11.06.2021 është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë neni 6 paragrafi 1, 2 dhe 3 ku përcaktohet se: *“Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive. 3. Procesit përzgjedhës, sipas paragrafit 2 të këtij neni, bazohet në vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve, nëpërmjet një konkurrimi të përgjithshëm, që përfshin një testim me shkrim dhe me gojë, si dhe çdo formë tjetër të përshtatshme të vlerësimit.”*, andaj mbi këtë bazë anulohet procedura e rekrutimit për pozitën e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë së Regjistrimit Civil e shpallur sipas konkursit të datës 11.06.2021.

Kolegji konstaton se procedura e rekrutimit lidhur me pozitën Drejtor Ekzekutiv në ARC/MPB duhet të rishpallet e mbyllur pasi që ka pasur kandidat të mjaftueshëm dhe kjo nuk ka qenë kontestuese dhe gjithashtu Kolegji konstaton se dy nga anëtarët e Komisionit të cilët nuk kanë tregu objektivitet dhe integritet gjatë procedurës së rekrutimit duhet të largohen nga Komisioni sa i përket kësaj procedure.

Andaj, pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.887/2021

Flakron GASHI



Zyrtar i Lart për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- *Ankuesit,*
- *Ministrin të Ministrisë së Punëve të Brendshme*
- *Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;*
- *Drejtorit të DZMP-së*
- *Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK- së.*